



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

RAPORT

I VETEVALUIMIT TË NJËSIVE AKADEMIKE

FAKULTETI EKONOMIK

PERIUDHA:

2019/20; 2020/21; 2021/22

Tetovë, 2024

Fakultetin Ekonomik - Економски факултет- Faculty of Economics
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| 1. Qëllimi i evaluimit..... | 3 |
| 2. Përshkrim i fakultetit | 3 |
| 2.1. Historiku | 3 |
| 2.2. plani strategjik | 6 |
| 2.2.1. Misioni dhe vizioni i Fakultetit Ekonomik | 7 |
| 2.1.2. Qëllimet strategjike të Fakultetit Ekonomik | 7 |
| 3. Struktura organizative e fakultetit | 10 |
| 3.1. Organogrami | 10 |
| 3.2. Deskriptorët | 11 |
| 3.3. Programet studimore të Fakultetit Ekonomik | 12 |
| 3.3.1 bashkëpunimi me kompanitë/institucionet në nivel të programeve studimore | 13 |
| 3.3.2. Programi studimor Ekonomi - Biznes | 13 |
| 3.3.3. Programi studimor Kontabilitet dhe Financa | 14 |
| 3.3.4. Programi studimor Menaxhment dhe Marketing | 14 |
| 3.3.5. Programi studimor Turizëm | 14 |
| 3.3.6. Programi studimor Biznes Ndërkombëtar | 14 |
| 3.4. Vlerësimi i plan-programit aktual në nivel të programeve studimore | 15 |
| 3.4.1. Programi studimor Ekonomi dhe Biznes | 15 |
| 3.4.2. Programi studimor Financa dhe Kontabilitet | 18 |
| 3.4.3. Programi studimor Marketing - Menaxhment | 21 |
| 3.4.4. Programi studimor Turizëm (akreditim prej vitit akademik 2021/22) | 23 |
| 4. Vlerësimi i programeve cikli ii | 25 |
| 5. Veprimtaria mësimore | 28 |
| 5.1. Struktura e kuadrit mësimor | 28 |
| 5.2. Struktura e studentëve | 32 |
| 5.2.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike | 32 |
| 5.2.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (master) | 38 |
| 6. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte | 39 |
| 7. Realizim i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit Ekonomik | 45 |
| 8. SWOT analiza dhe konkluzioni | 49 |

1. QËLLIMI I EVALUIMIT

Procesi i evaluimit të brendshëm qëllim kryesor ka rritjen e cilësisë, rritjen e konkurrencës në treg dhe ofrimin e programeve studimore në përputhshmëri me universitetet tjera në rajon dhe më gjerë. Po ashtu nëpërmjet evaluimit individual të pedagogëve tentohet të detektohen mangësitë dhe përparësitë në procesin mësimor me qëllim që të njëjtat të përmirësohen ose të zhvillohen.

Raporti i vetevaluimit për Fakultetin Ekonomik trajton këto pjesë:

1. Qëllimin e procesit të evaluimit;
2. Përshkrimin e Fakultetit (historiku dhe misioni);
3. Struktura organizative e Fakultetit (organogrami, deskriptorët dhe programet studimore);
4. Veprimtaria mësimore (struktura e kuadrit mësimor-shkencor dhe struktura e studentëve në tre ciklet studimore);
5. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte;
6. Rezultatet e evaluimit të orës mësimore;
7. SWOT analiza dhe konkluzioni;
8. Shtojca.

2. PËRSHKRIM I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Fakulteti Ekonomik, si pjesë e Universitetit të Tetovës u themelua më 17 dhjetor të vitit 1994 si iniciativë e intelektualëve shqiptarë, e shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike dhe të gjithë dashamirëve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Nga ky këndvështrim, zhvillimin si dhe veprimtarinë e USHT-së mund ta ndajmë në dy periudha:

- Periudha: 1994-2003, periudhë historike e krijimit të Fakultetit Ekonomik, si pjesë e Universitetit të Tetovës.
- Periudha: 2004-2010, periudha e zhvillimit institucional të Fakultetit, si pjesë e Universitetit të

Tetovës dhe koha e modernizimit akademik dhe fizik. Në këtë periudhë Fakulteti Ekonomik nga gjendja e emergjencës filloi të kalojë në shkallën e reformimit akademik, konceptual dhe institucional. Fakulteti Ekonomik funksionon që nga themelimi i Universitetit të Tetovës, dhe në këtë periudhë dhjetëvjeçare, 1994-2004, funksiononte Ekonomia e Përgjithshme si drejtim i vetëm me kohëzgjatje studimesh 4-vjeçare. Në të njëjtën mënyrë vazhdoi të funksionojë Fakulteti Ekonomik edhe pas zyrtarizmit në vitin 2004.

- Në vitin 2007, në Fakultetin Ekonomik u akredituan katër drejtime edhe atë Ekonomi - Biznes, Financa - Kontabilitet, Marketing - Menaxhment dhe Turizëm me kohëzgjatje studimi 3-vjeçar. Duke marrë parasysh nevojat gjithnjë e në rritje të popullatës për arsim të lartë në vendin tonë, me qëllim që t'u ofrohet të rinjve mundësia të shprehin potencialin e tyre, por në të njëjtën kohë edhe me ndryshimet në Ligjin për arsim të lartë në vitin 2008, programet studimore të Fakultetit Ekonomik hapën grupe të disperzuara në qytete të ndryshme në R. Maqedonisë së Veriut edhe atë në Strugë¹ edhe në Shkup². Këto studime të disperzuara aktualisht janë në pushim ndërsa, vendimi për pushim të regjistrimeve të studentëve të rinj nëpër disperzime është për arsye të rritjes së cilësisë.

Sot Universiteti i Tetovës ka shënuar të arritura të mëdha në të gjitha drejtimet. Ai është ngritur tashmë në një institucion arsimor dhe shkencor me përmasa kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare duke tërhequr kah vetja profesoratin më të mirë të vendit dhe rajonit, figurat më eminente të arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi me një infrastrukturë dhe nivel të lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe me avantazhe në raport me konkurrencën.

Avantazhet tona qëndrojnë në infrastrukturën që e përbëjnë sallat, laboratorët, amfiteatrot, programet studimore bashkëkohore në funksion të kërkesave të tregut dhe stafin akademik të kualifikuar që përdor literaturën më bashkëkohore.

- Periudha 2020-2022 i përkon pandemisë Covid 19 dhe si në të gjitha vendet edhe në vendin tonë ishte sfidë menaxhimi i pandemisë. Universiteti i Tetovës dhe Fakulteti Ekonomik e menaxhuan me sukses këtë perudhë duke u ofruar studentëve realizimin e mësimin përmes platformave online si dhe realizimin e provimeve online deri në tejkalimin e krizës dhe në përputhje me udhëzimet nga Ministria e Shëndetësisë.

Fakulteti Ekonomik deri në vitin akademik 2019/20 ishte i organizuar në 5 programe studimore:

1. Ekonomi - Biznes
2. Financa - Kontabilitet
3. Marketing - Menaxhment
4. Turizëm
5. Biznes Ndërkombëtar

Këto programe studimore janë të organizuara sipas standardeve më bashkëkohore, Sistemit të Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) të organizuara me akreditimin 4+1+3. Si përmbledhje në kuadër të Fakultetit Ekonomik zhvillohet mësimi në ciklin e parë, në ciklin e dytë dhe nga viti akademik 2015/2016 zhvillohet edhe shkolla e doktoraturës.

Nga viti akademik 2020/2021 mësimi zhvillohet sipas akreditimit të ri. Për studimet deridiplomike akreditim i ri i plan-programeve:

1. Ekonomi - Biznes
2. Financa - Kontabilitet
3. Marketing - Menaxhmenti
4. Turizëm

Në vijim paraqesim në formë tabelare drejtimit me kualifikimet përkatëse:

I. PROGRAMET STUDIMORE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE

| PROGRAMI STUDIMOR | S | ECTS | KUALIFIKIMI |
|---------------------------------|----------|------------|--|
| EKONOMI DHE BIZNES | 8 | 240 | Ekonomist i diplomuar në fushën e ekonomisë dhe biznesit |
| MARKETING DHE MENAXHMENT | 8 | 240 | Ekonomist i diplomuar në fushën e marketingut dhe menaxhmentit |
| FINANCA DHE KONTABILITET | 8 | 240 | Ekonomist i diplomuar në fushën e financave dhe kontabilitetit |
| BIZNES NDËRKOMBËTAR | 8 | 240 | Ekonomist i diplomuar në fushën e biznesit ndërkombëtar |
| TURIZËM | 8 | 240 | Menaxher i diplomuar i turizmit |

2.2 Plani strategjik

Fakulteti Ekonomik si një nga njësitë organizative më të vjetra dhe njërendi kyç në suaza të Universitetit të Tetovës, synon ndërtimin e kuadrove të reja nga të gjithë lëmenjtë e Ekonomisë dhe Shkencave Organizative. Ky Fakultet ofron pesë programe studimore në nivelin e studimeve deridiplomike dhe nëntë programe studimore në nivelin e studimeve pasdiplomike, njëri nga të cilët është program me karakter ndërkombëtar i përpiluar në bashkëpunim me Universitetin e Illinoisit Verior në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Krahas kësaj, Fakulteti ofron edhe një program studimor me tre drejtime në suaza të shkollës së doktoratës pranë Universitetit të Tetovës, duke e kompletuar në këtë mënyrë tërësinë e ofertës programore në të tre nivelet studimore. Që të gjitha programet studimore që ofrohen pranë Fakultetit Ekonomik janë të akredituara nga Bordi për Akreditim të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, në përputhëshmëri me dispozitat ligjore të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fakulteti Ekonomik krahas ofrimit të programeve të shumta studimore në tre ciklet studimore, bën pjesë në grupin e fakulteteve në aspektin kadrovik mirë të ekipuara me një staf akademik që në vete ngërthen ligjërues me një heterogjenitet të fushave studimore në lëmin e shkencave ekonomike. Fakulteti disponon kapacitete të mjaftueshme që krahas veprimtarisë së mësimdhënësve të ofrojë edhe mundësi të

shumta për bashkëpunim të ndërmjetëm në mes Universitetit dhe komunitetit të biznesit në kontekst të kyçjes së profesoratit në ballafaqimin me problemet dhe sfidat më të cilat janë të ballafaquara bizneset në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Krahas kësaj, Fakulteti Ekonomik disponon edhe kapacitete të mjaftueshme për zhvillim të programeve të reja studimore, për përpilim dhe zbatim të projekteve hulumtuese dhe profesionale në bashkëpunim me pretendentë të rëndësishëm dhe shumëçka tjetër.

Plani trevjeçar për zhvillim të Fakultetit është refleksion i aktiviteteve që dekanati dhe stafi akademik i Fakultetit Ekonomik synojnë të realizojnë për periudhën e viteve akademike 2019/2020, 2020/2021, 2021/2022.

2.2.1. Misioni dhe vizioni i Fakultetit Ekonomik

Misioni i Fakultetit Ekonomik është si vijon: “Përkushtim për profilizim të ekonomistëve të mirëfilltë, me tendencë të krijimit të potencës ekonomike si pjesë e detyrimit në përmirësimin e mirëqenies shoqërore”.

Vizioni i Fakultetit Ekonomik është si vijon: “Avangardë e ndryshimeve në studimet ekonomike në vend dhe rajon përmes kontribuit në zhvillimin dhe avancimin e disiplinave ekonomike si në kornizën shkencore-hulumtuese, ashtu edhe në atë arsimore”.

2.1.2. Qëllimet strategjike të Fakultetit Ekonomik

Si qëllime bazë strategjike në periudhën e ardhshme trevjeçare të Fakultetit Ekonomik mund të veçohen:

- Rishqyrtimi i kurrikulës së fakultetit, modernizimi i së njëjtës dhe përshtatja e saj ndaj nevojave praktike të shoqërisë sonë dhe kërkesave të tregut të punës.
- Hapja e drejtimeve të reja në studimet e ciklit të parë dhe modifikimi i drejtimeve aktuale duke filluar me ofrimin e drejtimeve fleksible që do të ofrohen për periudhë të caktuar 6-9-vjeçare me qëllim që programet e fakultetit të jenë gjithmonë në hap me kohën dhe ndryshimet e nevojave të tregut të punës, kuptohet duke u bazuar në analiza paraprake të thukëta dhe profesionale.
- Ofrimi i studimeve sipas parimit të moduleve.


- Përgatitje e një strategjie afatgjatë dhe plani operativ për nevojat për rikualifikim dhe trajnim të stafit akademik duke marrë për bazë strukturën aktuale moshore, shkencore dhe mësimore të ligjëruesve.
- Organizim permanent i trajnimeve në fushën e metodologjisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies për anëtarët e stafit akademik, në bashkëpunim me instancat më të larta menaxhuese të universitetit.
- Avancim i studimeve të ciklit të dytë duke filluar me ofrimin e programeve të reja studimore, modifikimin e disa programeve aktuale të tejkaluara dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u bazuar në një analizë paraprake të mirëfilltë të nevojave të tregut dhe studentëve.
- Analizë e thuktë e arsyeve për shkallën e ulët të regjistrimit të studentëve në programet master me qëllim të gjetjes së alternativave përkatëse për zmadhimin e numrit të kandidatëve për studime sipas sistemit në fjalë.
- Konform kornizës së universitetit krijimi i një sistemi për matjen dhe vlerësimin e performancës së çdo pjesëtari të stafit akademik me qëllim të identifikimit të mangësive potenciale dhe gjetjes së mënyrave përkatëse për rritjen e saj në drejtim të zmadhimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Ngritje e bashkëpunimit me fakultetet tjera në suaza të universitetit sipas parimeve të një partneriteti të mirëfilltë duke u bazuar në pikat e përbashkëta të kurrikulave.
- Nxitje e bashkëpunimit të Fakultetit Ekonomik me fakultetet simotra jashtë universitetit nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve për bashkëpunim dhe operacionalizim të marrëveshjeve të tilla.
- Përforsim i angazhimit praktik të studentëve gjatë studimeve të tyre deridiplomike e sidomos studimeve pasdiplomike.
- Zhvillimi dhe avancimi i studimeve të ciklit të tretë si kulminacioni i të arriturave të çdo institucioni të arsimit të lartë duke mbajtur llogari permanente për mbajtjen e një cilësie të lartë në organizimin e studimeve në fjalë.
- Në bashkëpunim me instancat më të larta të universitetit, përforsim i kapaciteteve të Fakultetit për të ofruar shërbime edhe për palë jashtë universitetit.

- Krijim i disa grupeve punuese në varshmëri nga fusha e specializimit më të ngushtë të mësimdhënësve me qëllim të nxitjes së punës ekipore në funksion të përgatitjes së projekteve hulumtuese-shkencore me të cilat Fakulteti Ekonomik do të aplikojë për financim pranë organizatave dhe rrjeteve ndërkombëtare. Kjo do të mundësojë në instancë të fundit ngritje të kapaciteteve hulumtuese të stafit të Fakultetit Ekonomik.
- Nxitje e stafit për të marrë pjesë në mënyrë më intensive në konferenca shkencore si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij.
- Angazhim i një numri të konsiderueshëm të stafit ndërkombëtar nga universitetet e dalluara amerikane dhe evropiane me qëllim të përfitimit nga përvojat e tyre mësimdhënëse.
- Angazhim i së paku dy ekspertëve ndërkombëtarë që do të kenë për obligim ofrimin e ndihmës dhe përkrahjes ndaj stafit lokal gjatë mentorimit të kandidatëve sidomos në studimet e ciklit të tretë.
- Bërja e hapave të parë në drejtim të inkorporimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë e të ligjëruarit në Fakultetin Ekonomik duke filluar me afrimin e lëndëve të caktuara në gjuhë angleze, lëndë këto që do të ligjërohen nga ligjërues kompetentë vendorë dhe ndërkombëtarë.
- Nxitje e stafit akademik për të inkorporuar teknikat më të reja të mësimdhënies me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- Krijim i një databaze me të dhëna për përfaqësues të institucioneve dhe organizatave relevante publike që do të marrin pjesë në mësimdhënie në formë të “guest lecturer” me qëllim të ofrimit të mundësive më të mëdha për të ndërlidhur teorinë me praktikën e shoqërisë sonë.
- Organizim i seminareve me qëllim të zhvillimit të aftësive hulumtuese të pjesëtarëve të stafit akademik.
- Bashkëpunim intensiv dhe permanent me Parlamentin Studentor për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me nxitjen e mësimnxënies dhe kapaciteteve administrative të Fakultetit Ekonomik.
- Përpjekje permanente për të përmirësuar burimet e Fakultetit Ekonomik në kontekst të pajisjeve teknike dhe literaturës, gjithësesi në bashkëpunim me instancat më të larta të universitetit.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Për realizimin e veprimtarisë së tij, Fakulteti Ekonomik është i organizuar në njësi të brendshme organizative në përputhje me Statutin e Universitetit. Në vazhdim, në një paraqitje skematike do të paraqesim strukturën organizative të Fakultetit Ekonomik:



3.2. Deskriptorët

Në të gjithadrejtimitet e Fakultetit Ekonomik studimet zgjasin 4 vjet dhe gjithsej grumbullohen 240 (ECTS) kredi. Procesi mësimor realizohet me mësim teorik, praktik si dhe do të realizohet mësimi klinik sipas Sistemit të Bolonjës të akredituar në vitin 2012.

Numri i kredive për çdo lëndë shtrihet prej 2 deri në 8 ECTS dhe në fund të studimeve studentët përgatisin temë diplome e cila përmban 6 kredi.

Mësimi ofrohet në bazë të rregullt (full-time) dhe me korrespondencë (part-time). Studentët ndjekin mësimin nga lëndët obligative dhe lëndët zgjedhore. Lëndët përfshijnë kredi, që përfaqësojnë korrespondojnë me 25-30 orë, nga kohëzgjatja e mësimdhënies së ligjëratave. Gjithashtu, në të gjitha drejtimitet, në afatet e parapara të semestrave përkatës realizohen kolokuiumet për çdo lëndë apo provimet në afatet e caktuara.

Çdo vit duhet të fitohen 60 kredi për 1500 -1800 orë në vit. Informata më të detajuara për politikën e kredive mund të merren në broshurën e Universitetit. Lëndët ndahen në njësi semestrale. Studentët duhet t'i kryejnë të gjitha lëndët sipas zhvillimit të programit të obliguar studimor. Pjesëmarrja në ligjëratat është e obligueshme dhe paraqet kusht primar që ta kalojnë lëndën me sukses. Çdo lëndë duhet të përfundojë, duke i plotësuar kërkesat e parashtruara në program (syllabusin) e lëndës.

Të gjitha drejtimitet e Fakultetit Ekonomik në formë unike i përgatisin studentët për pozita udhëheqëse në gjithë botën, si në organizatat fitimprurëse, po ashtu edhe në ato jofitimprurëse.

Këto studime pritet të japin rezultate profesionale, të përshtatshme me kërkesat të tregut të punës dhe, njëkohësisht shërbejnë si bazë e shëndoshë për studimet të mëtuqeshme në nivelin pasuniversitar. Sot, shumë organizata funksionojnë në nivel global. Për këtë arsye, programet janë të ndërtuara të ofrojnë qasje integrale të çështjeve të biznesit ndërkombëtar, duke përfshirë koncepte të biznesit ndërkombëtar gjatë tërë programit studimor të biznesit (kurrikulimit). Lëndët në programe prezantojnë perspektivë të bazuar në teori, që janë të lidhura ngushtë me aplikimin e tyre në botën e biznesit. Programet, pikënisje kanë aftësimin e studentëve me njohuri të përgjithshme të gjuhëve lokale dhe angleze, aftësive të teknologjive informative (TI), studimeve evropiane, metodologjinë kërkimore dhe aftësitë e studimit. Pastaj, studentët njoftohen me lëndët themelore të ekonomisë dhe të menaxhimit të biznesit, dhe më në fund fokusohen në lëndët e avancuara profesionale, si manaxhmenti financiar, marketingu, e-biznesi, dhe lëndët zgjedhore të avancuara.

Eksperienca e kombinuar profesionale dhe akademike e stafit të fakultetit tonë u përgjigjet sfidave të rrethanave të biznesit dhe të 'ekonomisë së re'.

Përfitim plotësues është se, studentët në semestrin e fundit janë të nxitur të marrin pjesë në punë praktike, me ç'rast u jepet mundësia të njohohen me botën reale të biznesit. Eksperienca e fituar gjatë punës praktike u lejon atyre të jenë në rrjedhë me kolegët e tyre në botën e biznesit në Evropë dhe në botë, si dhe për të bërë vetëvlerësimin e kompetencave dhe aftësive personale. Ndërkaq, meqë programet bazohen në akumulim të kredive nga modulet e përfshira në program, lejohet akumulim i kredive nga universitetet tjera/mundësohet transfer në program të vitit të dytë dhe në vitin e fundit të studimeve. Qasja e tillë bashkëkohore në mësimdhënie dhe pajisjet për mësim dhe mësimdhënie u përgjigjen standardeve të universiteteve të njohura në botë. Studentët tanë kanë bibliotekë të furnizuar mirë dhe laborator me qindra kompjuterë me linjë interneti. Departamentet bashkëpunojnë me shumë organizata serioze të suksesshme në vend. Falë autoritetit që ka UT-ja dhe me ekzistimin e qendrave të biznesit dhe qendrës së karrierës, mban lidhje të vazhdueshme afatgjatë me shumë organizata serioze dhe të suksesshme në vend. Një aktivitet i tillë i pozicionon të diplomuarit tanë një hap para në tregun e punës duke u mundësuar lehtësim në punësim dhe aplikim të njohurive të fituara në fushat përkatëse. Të diplomuarit do të kenë mundësi të punësohen në organizata të sektorit publik dhe privat, në sferën e funksioneve të biznesit, si udhëheqës, këshilltarë, administratorë, analistë financiarë, kontabilistë, udhëheqës të burimeve njerëzore, udhëheqës në marrëdhëniet publike, udhëheqës marketingu, studiues tregu dhe shumë pozita tjera sfiduese. Diploma, gjithashtu, ofron bazë për ndjekjen e studimeve pasuniversitare në shumë universitete të akredituara dhe shkolla të biznesit nëpër botë.

3.3. Programet studimore të Fakultetit Ekonomik

Programet studimore të Fakultetit Ekonomik janë të përpiluara dhe akredituara sipas standardeve dhe nevojave bashkëkohore (Sistemit të Bolonjës), që janë të pranuar në nivel nacional dhe atë ndërkombëtar. Programet studimore kanë për qëllim realizimin dhe organizimin e studimeve në mënyrë të tillë që studentët të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në fushën e ekonomisë, si dhe me aftësitë kryesore profesionale. Përveç pjesës teorike duhet të përvetësojnë gjithashtu aftësi specifike për zbatimin e tyre edhe në praktikë.

Fakulteti Ekonomik vitin akademik 2022/23 e ka filluar me programet e riakredituara në vitin 2021.

Këto programe studimore përmbajnë lëndë obligative dhe zgjedhore. Lëndët obligative janë nga fushat përkatëse të programeve studimore. Lëndët mësimore zgjedhore studentët i zgjedhin nga lista e lëndëve mësimore zgjedhore e programeve studimore që kanë numër të barabartë të ECTS kredive. Në listën e lëndëve mësimore zgjedhore përfshihen gjithashtu lëndë mësimore që mësohen në njësi tjera të universitetit. Përpos lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore, në programet studimore janë të parapara edhe lëndë opsionale (lëndët e lira zgjedhore) ku studentët mund të fitojnë njohuri dhe kredi nga këto lëndë. Në programin studimor të ciklit të parë të studimeve në Fakultetin Ekonomik parashihet edhe punimi përfundimtar (punimi i diplomës).

3.3.1 Bashkëpunimi me kompanitë/institucionet në nivel të programeve studimore

Programi studimor Ekonomi dhe Biznes ka marrëveshje bashkëpunimi me 15 kompani prej të cilave tre janë të sektorit publik. Rreth 47% e kompanive kontribuojnë plotësisht në realizimin e mësimit praktik të studentëve si dhe 53% e kompanive kontribuojnë pjesërisht në realizimin e mësimit praktik të tyre. Prej këtyre kompanive 60% janë burim i mundshëm i vendit të punës kurse 40% janë pjesërisht burim i mundshëm i vendit të punës.

Programi studimor Financa dhe Kontabilitet realizon bashkëpunimin me 15 kompani prej të cilave 3 janë të sektorit publik. Rreth 60% e kompanive kontribuojnë plotësisht në realizimin e mësimit praktik të studentëve. Prej këtyre kompanive 33% janë burim i mundshëm i vendit të punës dhe 67% janë pjesërisht burim i mundshëm i vendit të punës. Në kuadër të këtij programi studimor vlerësohet se duhet të vendosen marrëdhënie bashkëpunimi edhe me 5 kompani tjera publike (Drejtoria e të Ardhurave Publike, Regjistri Qendror i RMV-së, Agjencioni për Punësim i RMV-së, Drejtoria Doganore e RMV-së, BNJVL).

3.3.2. Programi Studimor Ekonomi - Biznes

Studentët, pas përfundimit të studimeve, aftësohen për ndërmarrjen e iniciativave në zbulimin dhe krijimin e sfidave afariste dhe mund të zhvillojnë karrierë profesionale në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe menaxhmentit, që kërkojnë inovacion, ndërmarrje të riskut dhe orientim drejt tregtimit.

3.3.3. Programi Studimor Kontabilitet dhe Financa

Ky program studimor u mundëson studentëve kompetenca të fituara për kryerjen e punëve të larta profesionale nga fusha e kontabilitetit, revizionit dhe vendimmarrjes financiare, në të gjithë sektorët ekonomikë: sektorin financiar (banka, kompani sigurimesh, fonde për investim, pensionale), sektorin profitabil (subjektet prodhuese, tregtare dhe shërbyese), shtëpitë e revizionit, sektorin publik etj.

3.3.4. Programi Studimor Menaxhment dhe Marketing

Mundëson sukses në realizimin e punëve në lëmin e veprimtarisë strategjike, komunikim në marketing, shërbime dhe ide, shitje, marrëdhënie me publikun, hulumtime në treg, etj., dhe atë në: ndërmarrje, institucione, agjenci të specializuara, marketing ndërkombëtar.

3.3.5. Programi Studimor Turizëm

Programi studimor përpos përfitimit të diturive akademike universitare nga lëmi i turizmit dhe menaxhmentit turistik, mundëson zhvillimin e aftësive për kryerjen e punëve në lëmin e turizmit dhe resurseve natyrore, aftësi për punë në procesin arsimor, si profesor i turizmit ose menaxher i turizmit etj.

3.3.6. Programi Studimor Biznes Ndërkombëtar

Nëpërmjet këtij programi synohet të pajisen studentët me njohuri për njohjen dhe operimin e bizneseve në aspektin ndërkombëtar si dhe të punësimit të studentëve të ekonomisë në kompani ndërkombëtare të cilat operojnë në vendin tonë.

Rëndësia e programeve rritet pasi që të gjitha programet e lartpërmendura ofrojnë:

- Programe të akredituara (konform procesit të Bolonjës), që janë të pranuar në nivel nacional dhe ndërkombëtar;

- Ambient dinamik dhe intelektual që stimulon aktivitet mësimor për të gjitha departamentet dhe studentët.
- Stimulim të kreativitetit, inovacioneve, cilësisë dhe studimit të qëndrueshëm;
- Staf akademik me përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Përmirësim të organizimit dhe administrimit dhe udhëheqjes duke zbatuar standarde evropiane.

3.4. Vlerësimi i plan-programit aktual në nivel të programeve studimore

3.4.1. Programi studimor Ekonomi dhe Biznes

Programi studimor Ekonomi dhe Biznes (akreditim deri në vitin akademik 2020/21)

- Në kuadër të programit studimor Ekonomi dhe Biznes, rreth 90% e lëndëve obligative dhe zgjedhore janë plotësisht ose pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit.
- Në të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara nga lëndët janë plotësisht në përputhshmëri me deskriptorët për zhvillim të kompetencave të programit studimor.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Ekonomi dhe Biznes relativisht përfshin një kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve në përjashtim të 6 lëndëve të cilat janë pjesërisht të vendosura në semestrin e duhur dhe 3 lëndë që aspak nuk janë të vendosura në të njëjtin semester ose u paraprijnë lëndëve, njohuritë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë.

Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse, në të gjitha lëndët janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.

- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit nga shkenca si përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, rreth 49% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësimin të kërkesave bashkëkohore dhe arritjeve në fushën e ekonomisë dhe biznesit.

Programi studimor Ekonomi dhe Biznes (akreditim prej vitit akademik 2021/22)

Qëllimi i programit studimor

Qëllimi i programit studimor Ekonomi dhe Biznes është t'u mundësojë studentëve t'i thellojnë njohuritë e tyre nga lëmi i ekonomisë, si dhe në lëmin profesional krahas pjesës teorike u mundëson aplikimin e këtyre njohurive edhe në praktikë me çka studentët do të kompletohen në fushën e ekonomisë që në të ardhmen të punojnë si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

Ky program studimor u mundëson studentëve përfitimin e njohurive dhe përvojave për: teori ekonomike, menaxhment, financa, analizë ekonometrike të të dhënave.

Sistemi i njohurive i ofruar në këtë program studimor dhe aftësitë që kanë studentët u mundëson që t'i mbarojnë studimet e ciklit të dytë dhe më gjërë, me çka do t'i rritin mundësitë e tyre në karrierë në lëmin e ekonomisë ose në hulumtimet në karrierën akademike.

Programi studimor ka për qëllim:

- Ti përgatitë studentët për ndërtimin e karrierës në ekonomi si dhe në sektorin e biznesit, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik;
- Të mundësojë përvetësimin e aftësive dhe përvojës kërkimore në: teori ekonomike, menaxhment, financa dhe analizën ekonometrike të të dhënave.
- Të zhvillojë konceptin e punës praktike për studentët.
- Të zhvillojë konceptin e të menduarit kritik te studentët.
- T'u mundësojë studentëve të angazhohen në mënyrë aktive në ligjërata në mënyrë që të kryejnë në mënyrë të pavarur kërkime në të gjitha fushat e ekonomisë dhe menaxhimit.
- Të mundësojë zhvillimin e aftësive personale, komunikuese, kërkimore dhe të tjera që janë të rëndësishme për punësim.

Gjatë studimeve, studentëve u jepet mundësia për praktikë, e cila do t'u mundësojë të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë fushë.

Tabela 1. Pasqyra e lëndëve obligative dhe lëndëve zgjedhore në programin studimor Ekonomi dhe Biznes

| Semestrat | Numri i lëndëve obligative | Numri i lëndëve zgjedhore | Gjithsej lëndë |
|-------------|----------------------------|---------------------------|----------------|
| I | 3 | 1 | 4 |
| II | 4 | 1 | 5 |
| III | 4 | 1 | 5 |
| IV | 4 | 1 | 5 |
| V | 4 | 1 | 5 |
| VI | 4 | 1 | 5 |
| VII | 4 | 1 | 5 |
| VIII | 4 | 1 | 5 |
| Gjithsej | 31 | 8 | 39 |
| % përqindja | 79.5 | 20.5 | 100 |

Në programin studimor Ekonomi dhe Biznes rreth 80% të lëndëve janë lëndë obligative kurse rreth 20% janë lëndë zgjedhore nga totali i lëndëve të përfshira në të VIII semestrat apo për të katër vitet e studimeve.

Për sa u takon kredive sipas ECTS kemi këtë pasqyrë:

Tabela 2. Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit të lëndëve obligative dhe zgjedhore

| Nr. | Kohëzgjatja e studimeve (vite)/ numri total i ECTS-ve të programit të studimit | Ngarkesa totale e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët obligative e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët zgjedhore e shprehur përmes ECTS | |
|-----|--|--|--|---|--|--|---|
| | | A | A1 | B | B1 | C | C1 |
| | | Numri i përgjiths | Përfaqësimi në përqindje i ECTS-ve nga lëndët mësimore | / Numri total i ECTS-ve nga lëndët obligative | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët mësimore obligative | Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimor | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët zgjedhore në raport me |

| | | mësimor e | të programit studimor | | në raport me numrin e përgjithshëm të ECTS në programin studimor | e zgjedhor e | numrin e përgjithshëm të ECTS në programin studimor |
|-----------|---------------|--------------|-----------------------------|------------|---|--------------------|--|
| 1. | 4 vite 240 | 240 | 100% | 208 | 86.66% | 32 | 13.33% |

3.4.2. Programi studimor Financa dhe Kontabilitet

Programi studimor Financa dhe Kontabilitet (akreditim deri në vitin akademik 2020/21)

- Në kuadër të programit studimor Financa dhe Kontabilitet, rreth 75% të lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, kurse rreth 18% janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas këtij klasifikimi.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Financa dhe Kontabilitet është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve. Prej lëndëve obligative, 9 lëndë janë pjesërisht të vendosura në semestrin e duhur dhe 2 lëndë aspak nuk janë të vendosura në të njëjtin semester, ose u paraprijnë lëndëve, njohuritë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse, në 86% të lëndëve janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse..

Lëndët në kuadër të programit studimor Financa dhe Kontabilitet përgjithësisht nxisin zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në treg të punës. Megjithatë, me qëllim të avancimit të kompetencave por edhe rritjes së efikasitetit të kuadrove të reja në fushën e biznesit, rreth 56% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë për azhurnim pasi që nxisin pjesërisht shkathtësi të cilat janë të aplikueshme në treg të punës sipas kërkesave bashkëkohore.

Qëllimi i programit studimor

Qëllimi i programit studimor Financa dhe Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës është t'u mundësojë studentëve të përvetësojnë njohuri të thelluara në fushën e financave dhe kontabilitetit dhe këto njohuri të fituara t'i zbatojnë në praktikë. Për arritjen e këtyre synimeve, ky program studimor trajton aspektet teorike të kësaj fushe, duke u fokusuar në zbatimin e tyre në praktikë.

Programi studimor Financa dhe Kontabilitet është formuar dhe strukturuar në përputhje me trendet zhvillimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vendet fqinje dhe më gjerë si një program që do t'u mundësojë gjeneratave të ardhshme të trajtojnë profesionalisht problemet thelbësore me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet dhe këto probleme t'i tejkalojnë duke u dhënë zgjidhje adekuate. Konkretisht, të diplomuarit e këtij programi studimor do të trajnohen për kryerjen e detyrave të kontabilitetit në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat funksionale në vend, si dhe të dinë të sigurojnë financa në punën e tyre. Synimi shumë themelor për prezantimin e këtij programi, në të njëjtën kohë, paraqet edhe arsyetimin bazë për zbatimin e tij.

Tabela 3. Pasqyra e lëndëve obligative dhe lëndëve zgjedhore në programin studimor Financa dhe Kontabilitet

| Semestrat | Numri i lëndëve obligative | Numri i lëndëve zgjedhore | Gjithsej lëndë |
|-------------|----------------------------|---------------------------|----------------|
| I | 3 | 1 | 4 |
| II | 4 | 1 | 5 |
| III | 4 | 1 | 5 |
| IV | 4 | 1 | 5 |
| V | 4 | 1 | 5 |
| VI | 4 | 1 | 5 |
| VII | 4 | 1 | 5 |
| VIII | 4 | 1 | 5 |
| Gjithsej | 31 | 8 | 39 |
| % përqindja | 79.5 | 20.5 | 100 |

Në programin studimor Financa dhe Kontabilitet rreth 80% të lëndëve janë lëndë obligative kurse rreth

19

20% janë lëndë zgjedhore nga totali i lëndëve të përfshira në të VIII semestrat apo për të katër vitet e studimeve.

Tabela 4. Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit të lëndëve obligative dhe zgjedhore

| Nr. | Kohëzgjatja e studimeve (vite)/ numri total i ECTS-ve të programit të studimit | Ngarkesa totale e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët obligative e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët zgjedhore e shprehur përmes ECTS | |
|-----------|--|---|--|---|--|---|---|
| | | A Numri i përgjithshëm i ECTS-ve nga lëndët mësimore të programit studimor | A1 Përfaqësimi në përqindje të ECTS nga lëndët mësimore të programit studimor | B / Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimore obligative | B1 Përfaqësimi në përqindje të ECTS nga lëndët mësimore obligative në raport me numrin e përgjithshëm të ECTS në programin studimor | C Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimore zgjedhore në raport me numrin e përgjithshëm të ECTS në programin studimor | C1 Përfaqësimi në përqindje të ECTS nga lëndët mësimore zgjedhore në raport me numrin e përgjithshëm të ECTS në programin studimor |
| 1. | 3 vjet 180 4 vjet 240 | 240 | 100% | 208 | 86.66% | 32 | 13.33% |

3.4.3. Programi studimor Marketing - Menaxhment

Programi studimor Marketing - Menaxhment (akreditim deri në vitin akademik 2020/21)

- Në kuadër të programit studimor Marketing - Menaxhment, rreth 75% të lëndëve obligative dhe 14% e lëndëve zgjedhore janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Marketing - Menaxhment relativisht e vështirëson zhvillimin dhe mbindërtimin e njohurive dhe shkathtësive të studentëve.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat angazhohen studentët në drejtim të përfitimit të kompetencave përkatëse në 50% të lëndëve obligative dhe 32% të lëndëve zgjedhore pjesërisht janë në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.

Programi studimor Marketing - Menaxhment (akreditim prej vitit akademik 2021/22)

Qëllimi i programit studimor

Marketingu si aftësi për vendosjen e suksesshme të produkteve dhe shërbimeve në treg, dhe menaxhimi si shkencë dhe aftësi për të siguruar menaxhim të suksesshëm të organizatave dhe institucioneve të biznesit në përgjithësi, janë dy nga aspektet themelore të cilave ndërmarrjet u bashkëngjiten. Përveç kësaj, trendet botërore mbështesin pikëpamjen se menaxhimi dhe marketingu do të fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në të ardhmen.

Programi studimor Marketing dhe Menaxhment është hartuar, formuar dhe strukturuar sipas trendeve zhvillimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vendet fqinje dhe më gjerë si program që do t'u mundësojë studentëve që në mënyrë profesionale të trajtojnë problemet thelbësore me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet dhe në mënyrën më të mirë të mundshme t'i zgjidhin ato. Konkretisht, të diplomuarit e këtij programi studimor do të trajnohen për kryerjen e detyrave menaxheriale në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat funksionale në vend. Synimi kryesor për prezantimin e këtij programi, në të njëjtën kohë, paraqet edhe arsyetimin bazë për zbatimin e tij.

Tabela 5. Pasqyra e lëndëve obligative dhe lëndëve zgjedhore në programin studimor Marketing dhe Menaxhment

| Semestrat | Numri i lëndëve obligative | Numri i lëndëve zgjedhore | Gjithsej lëndë |
|-------------|----------------------------|---------------------------|----------------|
| I | 3 | 1 | 4 |
| II | 4 | 1 | 5 |
| III | 4 | 1 | 5 |
| IV | 4 | 1 | 5 |
| V | 4 | 1 | 5 |
| VI | 4 | 1 | 5 |
| VII | 4 | 1 | 5 |
| VIII | 4 | 1 | 5 |
| Gjithsej | 31 | 8 | 39 |
| % përqindja | 79.5 | 20.5 | 100 |

Në programin studimor Marketing dhe Menaxhment rreth 80% e lëndëve janë lëndë obligative kurse rreth 20% janë lëndë zgjedhore nga totali i lëndëve të përfshira në të VIII semestrat apo për të katër vitet e studimeve.

Tabela 6. Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit të lëndëve obligative dhe zgjedhore

| Nr. | Kohëzgjatja e studimeve (vite)/ numri total i ECTS-ve të programit të studimit | Ngarkesa totale e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët obligative e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët zgjedhore e shprehur përmes ECTS | |
|-----|--|---|---|---|--|--|--|
| | | A | A1 | B | B1 | C | C1 |
| | | Numri i përgjithshëm i ECTS-ve nga lëndët mësimor | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët mësimor të | / Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimor obligative | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët mësimor obligative në raport me | Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimor e | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët zgjedhore në raport me numrin e |

| | | e | programit studimor | | numrin e përgjithshëm të ECTS në programin studimor | zgjedor e | përgjithshëm të ECTS në programin studimor |
|-----------|---------------|------------|-----------------------|------------|---|--------------|--|
| 1. | 4 vjet 240 | 240 | 100% | 208 | 86.66% | 32 | 13.33% |

3.4.4. Programi studimor Turizëm (akreditim prej vitit akademik 2021/22)

Qëllimi i programit studimor

Akreditimi aktual i programit studimor Turizëm përfaqëson një program të tërë studimi që realizohet në Fakultetin Ekonomik në UT. Programi i propozuar u jep të diplomuarve një gamë më të gjerë veprimi në punë.

Arsyeja e fillimit të ndryshimeve në programin studimor të Turizmit në Universitetin e Tetovës duhet kërkuar në nevojën për:

- Harmonizimin e profileve të studimeve pasuniversitare në Turizëm me ato të vendit dhe të rajonit.
- Nevojat e shoqërisë së gjerë për veprimtarinë ekonomike.
- Me ndryshimet e propozuara, bëhet përpjekje që programi aktual i studimit të harmonizohet me kurrikulat dhe programet e institucioneve të tjera të arsimit të lartë si nga shteti ashtu edhe nga rajoni
- Me programin e studimit në Turizëm synohet të arrihet hapja maksimale e studimeve, si dhe lëvizshmëria e studentëve, pasi brenda R.S. Maqedonia edhe në kuadër të Hartës Arsimore Evropiane dhe e njëjta është në përputhje me parimet themelore të Deklaratës së Bolonjës. Duhet theksuar se si kurrikula dhe programi studimor Turizëm, për konceptimin e turizmit dhe organizimin e studimeve, komisioni për përgatitjen e raportit u udhëhoqën plotësisht nga rregulloret ligjore që përmban Ligji për arsimin e lartë si dhe rekomandimet e kuadrit evropian të

studimeve në ekonomi, për të mundësuar që studimet të jenë të pajtueshme me studimet e tjera në Turizëm në të gjithë Evropën.

Tabela 7. Pasqyra e lëndëve obligative dhe lëndëve zgjedhore në programin studimor Turizëm

| Semestrat | Numri i lëndëve obligative | Numri i lëndëve zgjedhore | Gjithsej lëndë |
|-------------|----------------------------|---------------------------|----------------|
| I | 7 | 2 | 9 |
| II | 8 | 2 | 10 |
| III | 8 | 2 | 10 |
| IV | 8 | 2 | 10 |
| Gjithsej | 31 | 8 | 39 |
| % përqindja | 79.5 | 20.5 | 100 |

Në programin studimor Turizëm gjithashtu rreth 80% të lëndëve janë lëndë obligative kurse rreth 20% janë lëndë zgjedhore nga totali i lëndëve të përfshira në të IV semestrat.

Tabela 8. Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit të lëndëve obligative dhe zgjedhore

| Nr. | Kohëzgjatja e studimeve (vite)/ numri total i ECTS-ve të programit të studimit | Ngarkesa totale e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët obligative e shprehur përmes ECTS | | Ngarkesa për lëndët zgjedhore e shprehur përmes ECTS | |
|-----|--|--|---|--|--|--|---|
| | | A | A1 | B | B1 | C | C1 |
| | | Numri i përgjithshëm i ECTS-ve nga lëndët mësimore | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët mësimore të programit studimor | / Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimore obligative | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët mësimore obligative në raport me numrin e përgjithshëm të ECTS në | Numri total i ECTS-ve nga lëndët mësimore zgjedhore | Përfaqësimi në përqindje i ECTS nga lëndët mësimore zgjedhore në raport me numrin e përgjithshëm të ECTS në |

| | | | | | | | |
|-----------|--------------------------------|------------|-------------|------------|--------------------|-----------|--------------------|
| | | | | | programin studimor | | programin studimor |
| 1. | 3 vjet 180 4 vjet 240 | 240 | 100% | 208 | 86.66% | 32 | 13.33% |

4. Vlerësimi i programeve cikli II

Në ciklin e dytë të studimeve programet studimore janë të organizuara si vijon:

PROGRAMET STUDIMORE NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

| PROGRAMI STUDIMOR | S | ECTS | KUALIFIKIMI |
|---|----------|------------|---|
| MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE | 2 | 60 | Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e menaxhmentit dhe burimeve njerëzore |
| MENAXHMENT | 2 | 60 | Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e menaxhmentit |
| MARKETING | 2 | 60 | Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e marketingut |
| FINANCA, BANKA DHE SIGURIME | 2 | 60 | Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e financave, bankave dhe sigurimeve |
| FINANCA DHE KONTABILITET | 3 | 120 | Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e financave dhe kontabilitetit |
| KONTABILITET DHE AUDITIM | 2 | 60 | Magjistër në fushën e kontabilitetit dhe auditimit |

Qëllimi i programit studimor **Menaxhimi i Burimeve Njerëzore** është që t'u ofrojë studentëve aftësitë e nevojshme profesionale për zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Studentët do të përfitojnë një sistem njohurish për rolin dhe fushat kryesore të veprimtarisë, rolin dhe funksionet e një menaxheri të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale, duke i lejuar ata të fillojnë me sukses punën në një numër fushash kryesore të aktiviteteve të menaxherit të burimeve njerëzore - përzgjedhja, përshtatja, trajnimi, motivimi i stafit, etj., formimi i vizionit sistematik dhe kompetencave të nevojshme për të kryer veprimtari profesionale në fushën e menaxhimit të personelit, prezantimi i përvojës praktike në aplikimin e teknologjive kryesore për menaxhimin e burimeve njerëzore nga pikëpamja e metodologjisë së një qasjeje sistematike.

Objekti i përgjithshëm i programit studimor **Menaxhment në ciklin e dytë të studimeve** është të zhvillojë aftësitë analitike dhe strategjike, duke promovuar konceptet që derivojnë nga një fushë e gjerë e disiplinave akademike. Ky program u mundëson studentëve të reflektojnë kreativitet dhe efikasitet dhe të sfidohen me rrethinën globale të biznesit. Studimet ofrojnë një rrjet integral konceptual dhe empirik për fusha gjenerike të menaxhmentit dhe biznesit. Pas përfundimit të suksesshëm të këtij programi akademik, studenti do të jetë në gjendje: të operojë në rrethinën konkurruese të biznesit; të analizojë në nivel strategjik, të zgjedhë probleme dhe të marrë vendime në rrethinën shumë komplekse dhe të ndryshueshme të biznesit; të aplikojë njohuritë e tij në praktikë dhe të komunikojë ato audiencë të specializuara në mënyrë të qartë dhe të bindshme; të përgatisë dhe të prezantojë teza, raporte dhe seminare sipas standardeve profesionale; të udhëheqë projekte investive; të organizojë dhe të zbatojë një projekt hulumtues; të menaxhojë kohën në mënyrë efikase dhe të pavarur.

Programi studimor **Marketing në ciklin e dytë të studimeve** u ofron studentëve standarde të larta dhe karrierë të suksesshme në sektorin e marketingut, të fokusuar në sjelljen e njeriut, organizatat, aftësitë komunikuese, operacionet, marketingun, financat, sistemet informative të menaxhmentit dhe ndikimin e tyre në vendimmarrjen menaxheriale. Modulet të cilat zhvillohen në këtë program, kanë për qëllim të formojnë ekspertë të aftë me dije dhe shkathtësi për të zbatuar standarde ndërkombëtare të zhvillimit për nevojat e menaxhimit të dijes dhe aftësive menaxhuese nga fusha e marketingut. Pas përfundimit të suksesshëm të këtij programi akademik, studentët do të jenë në gjendje: t'i njohin dhe t'i caktojnë problemet dhe çështjet sipas rëndësisë së tyre, të zotërojnë dijeni të mirë për aktivitetet esenciale të marketingut dhe administrimit të biznesit; t'i elaborojnë dallimet

dhe nevojat e bashkësisë në lidhje me marketingun nga aspekti shkencor dhe profesional, t'i zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara gjatë studimeve, përmes analizave komplekse nga sfera e marketingut, të zbatojnë aftësi dhe teknika për aplikimin e marketingut në situata të ndryshme si dhe t'i njohin alternativat e mundshme për problemet e posaçme dhe të bëjnë zgjedhje praktike midis tyre.

Programi studimor i specializuar në fushën **Financa, Banka dhe Sigurime** në ciklin e dytë të studimeve ka për qëllim të formojë ekspertë të cilët janë në gjendje të kryejnë analiza financiare te problemeve dhe zhvillimeve brenda një kuadri teorik dhe kuantitativ, kështu që pas përfundimit të suksesshëm të këtij programi akademik, studenti do të jetë në gjendje: të ofrojë një sfond solid për studentët që dëshirojnë të ndjekin një karrierë profesionale në industrinë financiare si analistë financiarë, kryeshefa/menaxherë financiarë dhe menaxherë të portofolit. Punëdhënësit e ardhshëm përfshijnë bankat komerciale, bankat qendrore, firmat bankare investuese, kompanitë e sigurimeve si dhe institucionet e tjera financiare vendore apo edhe ndërkombëtare. Programi gjithashtu ofron një sfond solid për studentët që ndjekin një karrierë në hulumtim dhe mësimdhënie akademike në fushën e ekonomisë financiare. Analiza duhet gjithashtu t'u mundësojë atyre që të punojnë jashtë apo t'u përshtaten strategjive të kompanive ekzistuese.

Objektivi kryesor i programit studimor **Financa dhe Kontabilitet në ciklin e dytë** të studimeve është t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme në fushën e Financës - Kontabilitetit me qëllim formimin e specialistëve të aftë për të punuar në këto fusha, si specialistë finance dhe kontabiliteti të njësive të vogla e të mesme të sektorit privat dhe institucioneve publike. Programet e lëndëve të këtij studimi ofrojnë thellim, zgjerim dhe specializim të njohurive teorike dhe aftësi për kërkim të avancuar dhe të pavarur shkencor. Synohet pajisja e studentit me mjetet, aftësitë dhe njohuritë e thelluara teorike shkencore për një karrierë të suksesshme profesionale dhe akademike nga njëra anë dhe nga ana tjetër krijimi i një profili të pashkëputur me përshtatjen e aftësive të tyre në praktikë. Në fokusin e tij të plotë ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si edhe për t'i ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e financave dhe kontabilitetit nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur fuqishëm nga praktika shkencore dhe hulumtuese në financë.

Qëllimi i programit studimor **Kontabilitet dhe Auditim** në ciklin e dytë të studimeve në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës është që të ndërtojë te studentët njohuri të avancuara teorike dhe profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, të cilët fitojnë shkathtësi të

hulumtimit të pavarur shkencor, të cilët janë konkurrentë në tregun vendor, regjional dhe ndërkombëtar të punës dhe të cilët i kontribuojnë korporatave dhe komunitetit të biznesit përmes hartimit të strategjive për zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen e duhur. Qëllimi i programit të studimit Kontabilitet dhe Auditim është ofrimi i një programi cilësor pasuniversitar i cili është në përputhje me standardet më të larta akademike dhe shkencore dhe i cili i përgatit studentët për avancim në tregun e punës të cilët janë të aftë të punojnë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit. Përgjithësisht programi është hartuar në atë mënyrë që përmban disa lëndë kryesore - bazike që janë të profesionit, lëndë të përgjithshme që përfshijnë fushat që lidhen ngushtë me profesionin e Kontabilitetit dhe Auditimit, pastaj disa lëndë zgjedhore, të cilat i ndihmojnë studentit që të zgjedhë lëndë sipas interesimit të tij për fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit.

5. VEPRIMTARIA MËSIMORE

5.1. Struktura e kuadrit mësimor


Në Fakultetin Ekonomik procesin mësimor në vitin akademik 2019/20 e kanë realizuar gjithsej 48 mësimdhënës me kohë të plotë. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin Ekonomik realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës. Në vitin akademik 2019/20 në Fakultetin Ekonomik kanë qenë të punësuar 38 mësimdhënës dhe 10 bashkëpunëtorë dhe asistentë të rregullt.

Tabela 9. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe sipas gjinisë në vitin akademik 2019-20 në Fakultetin Ekonomik

| NR. | THIRRJA | Statusi i punës | | Gjinia | |
|-----|--------------|-----------------|-------------|--------|---|
| | | Të rregullt | Part – time | M | F |
| 1. | ORDINAR | 3 | | 3 | |
| 2. | INORDINAR | 20 | | 14 | 6 |
| 3. | DOCENT | 15 | | 9 | 6 |
| 4. | ASISTENT | 7 | | 5 | 2 |
| 5. | DEMONSTRATOR | 3 | | 2 | 1 |

Nëse analizojmë proporcionin gjinor të stafit akademik gjatë këtij viti, vërejmë se 12 mësimdhënës dhe 3 asistentë janë të gjinisë femërore kurse 26 mësimdhënës dhe 7 asistentë janë të gjinisë mashkullore. Kjo ka të bëjë edhe me nivelin e arsimit të gjinisë femërore në tërësi në bashkësinë tonë, megjithatë përfshirja solide e gjeneratave të reja të gjinisë femërore kontribuon që, marrë në tërësi, të krijohet një balancim gjinor i stafit akademik në Fakultetin Ekonomik. Për nga përgatitja profesionale dhe titujt akademikë siç mund të vëreni në grafikun më poshtë nga stafi i rregullt 6% janë profesorë ordinarë, 42% janë profesorë inordinarë, 31% janë me titull akademik docent, 15% janë asistentë dhe 6% janë demonstratorë.

Grafiku 1. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë



Sa i përket procesit mësimor në vitin akademik 2020/21 e kanë realizuar gjithsej 49 mësimdhënës me kohë të plotë dhe 14 me kohë të pjesshme. Në vitin akademik 2020/21 në Fakultetin Ekonomik kanë qenë të punësuar 47 mësimdhënës dhe 2 asistentë të rregullt. Të dhënat mund t'i paraqesim në tabelën më poshtë:


Tabela 10. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin

akademik 2020-21 në Fakultetin Ekonomik

| NR. | THIRRJA | Statusi i punës | | Gjinia | |
|-----|--------------|-----------------|-------------|--------|----|
| | | Të rregullt | Part – time | M | F |
| 1. | ORDINAR | 4 | / | 4 | / |
| 2. | INORDINAR | 26 | 1 | 18 | 9 |
| 3. | DOCENT | 17 | 9 | 13 | 13 |
| 4. | ASISTENT | 1 | 4 | 1 | 4 |
| 5. | DEMONSTRATOR | 1 | / | / | 1 |

Nëse analizojmë proporcionin gjinor të stafit akademik gjatë këtij viti, vërejmë se 22 mësimdhënës dhe 5 asistentë janë të gjinisë femërore kurse 37 mësimdhënës dhe 1 asistent janë të gjinisë mashkullore. Kjo ka të bëjë edhe me nivelin e arsimit të gjinisë femërore në tërësi në bashkësinë tonë, megjithatë përfshirja solide e gjeneratave të reja të gjinisë femërore kontribuon që, marrë në tërësi, të krijohet një balancim gjinor i stafit akademik në Fakultetin Ekonomik. Megjithatë, për të ruajtur nivelin e kualitetit si dhe njëkohësisht për të kontribuar në mbarëvajtjen efektive dhe produktive të procesit të mësimdhënies në Fakultetin Ekonomik janë angazhuar edhe 14 mësimdhënës me kontratë, respektivisht 10 profesorë dhe 4 asistentë. Për nga përgatitja profesionale dhe titujt akademikë siç mund të vëreni në grafikun më poshtë nga stafi i rregullt, 8% janë profesorë ordinarë, 53% janë profesorë inordinarë, 35% janë me titull akademik docentë, 2% janë asistentë dhe 2% demonstratorë. Siç mund të vereni, gjatë këtij viti kemi avancim në tituj shkencorë të stafit të brendshëm.

Grafiku 2. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë




Sa i përket procesit mësimor në vitin akademik 2021/22, është realizuar nga gjithsej 34 mësimdhënës me kohë të plotë dhe 14 me kohë të pjesshme. Në vitin akademik 2021/22 në Fakultetin Ekonomik kanë qenë të punësuar 32 mësimdhënës dhe 2 bashkëpunëtorë dhe asistentë të rregullt.

Tabela 11. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2020-21 në Fakultetin Ekonomik

| NR. | THIRRJA | Statusi i punës | | Gjinia | |
|-----|--------------|-----------------|-------------|--------|---|
| | | Të rregullt | Part – time | M | F |
| 1. | ORDINAR | 5 | | | |
| 2. | INORDINAR | 18 | 1 | | |
| 3. | DOCENT | 9 | 9 | | |
| 4. | ASISTENT | 2 | 4 | | |
| 5. | DEMONSTRATOR | | | | |

Për nga përgatitja profesionale dhe titujt akademikë siç mund të vëreni në grafikun më poshtë nga stafi i rregullt, 15% janë profesorë ordinarë, 53% janë profesorë inordinarë, 35% janë me titull akademik docentë, 2% janë asistentë dhe 2% demonstratorë. Siç mund të vëreni, gjatë këtij viti kemi rritje të numrit të profesorëve ordinarë.

Grafiku 3. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë



5.2. STRUKTURA E STUDENTËVE

5.2.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike


Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2019/2020, në drejtimin Kontabilitet - Financa, rreth 30 studentë janë me status të rregullt kurse 4 me korrespondencë; në drejtimin Marketing - Menaxhment 36 studentë janë me status të rregullt kurse 5 me korrespondencë, prej të cilëve 21 femra dhe 20 meshkuj; në drejtimin Ekonomi - Biznes 27 studentë janë me status të rregullt, kurse 3 me korrespondencë, prej të cilëve 16 femra dhe 14 meshkuj; në drejtimin Turizëm, 8 studentë janë me status të rregullt kurse 4 me korrespondencë, në drejtimin Biznes Ndërkombëtar, 4 studentë janë me status të rregullt kurse 2 me korrespondencë prej të cilëve 4 femra dhe 2 meshkuj.

Tabela 12. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Kontabilitet - Financa

| Viti akademik | M | F | Të rregullt | Me korrespondencë | Nr. i studentëve të regjistruar |
|---------------|----|----|-------------|-------------------|---------------------------------|
| 2019-2020 | 16 | 18 | 30 | 4 | 34 |
| 2020-2021 | 17 | 22 | 36 | 3 | 39 |
| 2021-2022 | 11 | 22 | 29 | 4 | 33 |

Sa i përket strukturës gjinore në drejtimin Kontabilitet - Financa, në vitin akademik 2019/2020, ka pasur 53% femra 47% studentë meshkuj, në vitin 2020/21 ka pasur 56% femra dhe 44% meshkuj dhe në vitin 2021/22 ka pasur 67% femra dhe 33% studentë meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 4. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Kontabilitet - Financa




Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2020/2021, në drejtimin Kontabilitet - Financa 36 të studentë janë me status të rregullt dhe 3 studentë me korrespondencë prej të cilëve 22 femra dhe 17 meshkuj; në drejtimin Marketing - Menaxhment 28 studentë janë me status të rregullt dhe 2 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 13 femra dhe 18 meshkuj, në drejtimin Ekonomi - Biznes 28 studentë janë me status të rregullt dhe 6 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 14 femra dhe 20 meshkuj; në drejtimin Turizëm 7 studentë janë me status të rregullt dhe 2 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 3 femra dhe 6 meshkuj; në drejtimin Biznes Ndërkombëtar 13 studentë janë me status të rregullt dhe 2 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 8 femra dhe 7 meshkuj.

Tabela 13. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Marketing - Menaxhment

| Viti akademik | M | F | Të rregullt | Korrespondencë | Nr. i studentëve të regjistruar |
|---------------|----|----|-------------|----------------|---------------------------------|
| 2019-2020 | 21 | 20 | 36 | 5 | 41 |
| 2020-2021 | 12 | 18 | 28 | 2 | 30 |
| 2021-2022 | 9 | 11 | 16 | 4 | 20 |

Sa i përket strukturës gjinore në drejtimin Marketing - Menaxhment, në vitin akademik 2019/2020, ka pasur 49% femra 51% studentë meshkuj; në vitin akademik 2020/21 ka pasur 60% femra dhe 40% meshkuj dhe në vitin akademik 2021/22 ka pasur 55% femra dhe 45% meshkuj studentë në studimet baçelor.

Grafiku 5. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Marketing - Menaxhment



Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara, në vitin akademik 2021/22 në drejtimin Kontabilitet - Financa rreth 29 të studentëve janë me status të rregullt dhe 4 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 22 femra dhe 11 meshkuj; në drejtimin Marketing - Menaxhment 16

studentë janë me status të rregullt dhe 4 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 11 femra dhe 9 meshkuj; në drejtimin Ekonomi - Biznes 20 studentë janë me status të rregullt dhe 2 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 12 femra dhe 10 meshkuj; në drejtimin Turizëm 4 studentë janë me status të rregullt dhe 1 student me korrespondencë, prej të cilëve 1 femra dhe 4 meshkuj; në drejtimin Biznes Ndërkombëtar 5 studentë janë me status të rregullt dhe 0 studentë me korrespondencë prej të cilëve 3 femra dhe 2 meshkuj.

Tabela 14. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Ekonomi - Biznes

| Viti akademik | M | F | Të rregullt | Korrespodencë | Nr. i studentëve të regjistruar |
|---------------|----|----|-------------|---------------|---------------------------------|
| 2019-2020 | 14 | 16 | 27 | 3 | 30 |
| 2020-2021 | 20 | 14 | 28 | 6 | 34 |
| 2021-2022 | 10 | 12 | 20 | 2 | 22 |

Sa i përket strukturës gjinore në drejtimin Ekonomi - Biznes, në vitin akademik 2019/20 ka pasur 53% femra dhe 47% meshkuj studentë, në vitin akademik 2020/21 ka pasur 41% femra dhe 59% meshkuj dhe në vitin akademik 2021/22 ka pasur 55% femra dhe 45% meshkuj studentë në studimet baçelor.

Grafiku 6. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Ekonomi - Biznes




Tabela 15. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Turizëm

| Viti akademik | M | F | Të rregullt | Me korrespondencë | Nr. i studentëve të regjistruar |
|---------------|----|---|-------------|-------------------|---------------------------------|
| 2019-2020 | 12 | | 8 | 4 | 12 |
| 2020-2021 | 6 | 3 | 7 | 2 | 9 |
| 2021-2022 | 4 | 1 | 4 | 1 | 5 |

Sa i përket strukturës gjinore në drejtimin Turizëm, në vitin akademik 2019/20 ka pasur 100% studentë meshkuj, në vitin 2020/21 ka pasur 67% femra dhe 33% meshkuj dhe në vitin akademik 2021/22 ka pasur 80% meshkuj dhe 20% femra studente në studimet baçelor.

Grafiku 7. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Turizëm




Tabela 16. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Biznes Ndërkombëtar


| Viti akademik | M | F | Të rregullt | Me korrespondencë | Nr. i studentëve të regjistruar |
|---------------|---|---|-------------|-------------------|---------------------------------|
| 2019-2020 | 2 | 4 | 4 | 2 | 6 |
| 2020-2021 | 7 | 8 | 13 | 2 | 15 |
| 2021-2022 | 2 | 3 | 5 | | 5 |

5.2.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (master)

Në vitin akademik 2019/20 në studimet e ciklit të dytë master janë regjistruar gjithsej 21 studentë vendas dhe 3 studentë shtetas të huaj prej të cilëve 1 në drejtimin Ekonomi - Biznes, 8 në drejtimin Financa dhe Kontabilitet, 2 Kontabilitet dhe Revizion, 9 në drejtimin Marketing - Menaxhment (3+2), 3 në drejtimin Marketing - Menaxhment (4+1) dhe 1 student në drejtimin Turizëm.

Sa i përket strukturës gjinore në drejtimin Biznes Ndërkombëtar në vitin akademik 2019/20, 67% janë femra dhe 33% meshkuj studentë, në vitin 2020/21 ka pasur 53% femra dhe 47% meshkuj dhe në vitin akademik 2021/22 ka pasur 60% femra dhe 40% studentë meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 8. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Biznes Ndërkombëtar



| Drejtimi | Programi studimor | F (gjinia) | M (gjinia) | RMV | Shtetas te huaj | Gjithsej |
|-----------------------------|-------------------|------------|------------|-----|-----------------|----------|
| Financa dhe Kontabilitet | 4+1 | 2 | 3 | 5 | 0 | 5 |
| Financa dhe Kontabilitet | 3+2 | 14 | 6 | 18 | 2 | 20 |
| Kontabilitet dhe Auditim | 4+1 | 2 | 1 | 3 | 0 | 3 |
| Marketing | 3+2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| Marketing | 4+1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 |
| Marketing dhe Menaxhment | 3+2 | 4 | 1 | 4 | 1 | 5 |
| Menaxhment | 4+1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| Financa, Banka dhe Sigurime | 4+1 | 2 | 0 | 1 | 1 | 2 |
| | | | | | | 38 |

6. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve hulumtuese, Fakulteti Ekonomik organizon Konferenca Shkencore me bord editorial nga pedagogë vendas dhe pedagogë me të cilët Universiteti ynë ka bashkëpunim të ndërsjellë dhe boton revistën shkencore “Economic Vision” me bord nga pedagogë vendas dhe të huaj. Në periudhën e analizuar janë botuar tre vëllime të revistës shkencore edhe atë të përmbledhura si vijon:

Tabela 18. Revistat shkencore të publikuara nga Fakulteti Ekonomik gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 (ISSN: 1857-9566 Print; ISSN: 2545-4544 (Online))

| TITULLI I REVISTËS | VOLUMI, VITI |
|--|---------------------------------------|
| <i>ECONOMIC VISION</i> <i>International Scientific Journal in</i> <i>Economics, Finance, Business,</i> <i>Marketing, Management and Tourism</i> | vol 7, No. 13-14, pp 1-279, viti 2020 |

| | |
|--|--|
| <i>ECONOMIC VISION</i> <i>International Scientific Journal in</i> <i>Economics, Finance, Business, Marketing,</i> <i>Management and Tourism</i> | vol 8, No. 15-16, pp 1-237, viti 2021 |
| <i>ECONOMIC VISION</i> <i>International Scientific Journal in</i> <i>Economics, Finance, Business, Marketing,</i> <i>Management and Tourism</i> | Vol 9, No 17-18, pp 1-171, viti 2022 |

Vijueshmëria aktive e stafit si pjesëmarrës dhe organizatorë të konferencave dhe tryezave të rumbullakëta, ka rezultuar me prezente të suksesshme të arritjeve shkencore dhe me bashkëpunime të ardhshme në hulumtime shkencore mes pedagogëve të univesitetit tonë dhe universiteteve tjera. Po ashtu organizimet e konferencave kanë mundësuar shkëmbim të stafit të Fakultetit Ekonomik dhe fakulteteve tjera sidomos për ciklet e studimit të nivelit të dytë dhe të tretë.

Organizim i sukseshëm i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare në organizim të Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Administrim Biznesit dhe Universitetit të Maltës në vitin akademik 2019/20 si dhe organizim i debatit shkencor.

Gjatë vitit akademik 2020-2021 stafi akademik, menaxhmenti i Fakultetit Ekonomik kanë qenë të kyçur në një serë aktivitetesh që kanë rezultuar me përfitime të shumta duke filluar nga begatimi i biografive profesionale të anëtarëve të stafit akademik, përmes pasurimit të ofertës programore të Fakultetit e deri te ngritja e reputacionit të Fakultetit në opinionin publik. Arritjet dhe zhvillimet profesionale të stafit akademik i paraqesim në formë të përmbledhur në tabelat në vijim.

Pedagogët e Fakultetit Ekonomik janë angazhuar në organizimin e konferencave shkencore të paraqitura në formë të përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 19. Aktivitetet e realizuara dhe rezultatet e arritura në fushën e organizimit të konferencave shkencore

| Nr. rendor | Person kontakti në Fakultetin Ekonomik | Emri i konferencës | Përfaqësues të Fakultetit Ekonomik në bordin shkencor të Konferencës |
|-------------------|--|---|---|
| 1 | Prof. Dr. Besa Xhaferi dhe Prof. Dr. Aida Yzeiri Baftijari | Reinventing marketing in the pandemic era | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Prof. Dr. Raman Ismaili ▪ Prof. Dr. Brikend Aziri ▪ Prof. Dr. Aida Yzeiri Baftijari ▪ Prof. Dr. Sheherzada Murati ▪ Prof. Dr. Hasim Deari ▪ Prof. Dr. Besa Xhaferi |
| 2 | Prof. Dr. Brikend Aziri | Rebound, rebuild and reinvent for a sustainable and equitable development | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Prof. Dr. Arben Oda |

Po ashtu pedagogët e Fakultetit Ekonomik duke dashur që të jenë në hap me trendet bashkëkohore kanë ndjekur trajnime për përsosje profesionale edhe atë të paraqitura në formë të përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 20. Aktivitetet e realizuara dhe rezultatet e arritura në fushën e organizimit të trajnimeve për stafin akademik të Universitetit të Tetovës

| Nr. rendor | Bartës i procesit në Fakultetin Ekonomik | Organizues i trajnimit | Titulli i trajnimit | Pjesëmarrës nga Fakulteti Ekonomik |
|-------------------|---|-------------------------------|----------------------------|---|
| 1 | Prof. Dr. Brikend Aziri | MonsoonSIM | How to use MonsoonSIM | Prof. Dr. Brikend Aziri Prof. Dr. Aida Yzeiri Baftijari Prof. Dr. Bardhyl |

| | | | | |
|---|----------------------------|--------|----------------------------|--|
| | | | | Dauti Prof. Dr. Besa Xhaferi |
| 2 | Prof. Dr. Brikend Aziri | AURORA | Social entrepreneurship | Prof. Dr. Brikend Aziri Prof. Dr. Aida Yzeiri Baftijari Prof. Dr. Bardhyl Dauti Prof. Dr. Almira Curri Prof. Dr. Arjeta Amzai Prof. Dr. Sheherzada Murati Prof. Dr. Merale Fetahu Vehapi Mr. Kajdafa Ademi |
| 2 | Prof. Dr. Brikend Aziri | AURORA | Diversity and inclusion | Prof. Dr. Brikend Aziri Prof. Dr. Aida Yzeiri Baftijari Prof. Dr. Bardhyl Dauti Prof. Dr. Almira Curri Prof. Dr. Arjeta Amzai Prof. Dr. Sheherzada Murati Prof. Dr. Merale Fetahu Vehapi Mr. Kajdafa Ademi |

Aktivitetin shkencor, pedagogët e Fakultetit Ekonomik e kanë realizuar edhe si anëtarë të këshillave shkencorë në konferenca shkencore ndërkombëtare.

Tabela 21. Pjesëmarrja e stafit akademik të Universitetit të Tetovës në cilësinë e anëtarëve të këshillit

shkencor në konferenca shkencore ndërkombëtare

| Nr. rendor | Anëtari i stafit | Emërtimi i konferencës | Organizatorët e konferencës |
|-------------------|--|---|--|
| 1 | 1.Prof. Dr. Raman Ismaili 2.Prof. Dr. Brikend Aziri 3.Prof. Dr. Aida Yzeiri Baftijari 4.Prof. Dr. Sheherzada Murati 5.Prof. Dr. Hasim Deari 6.Prof. Dr. Besa Xhaferi | Reinventing marketing in the pandemic era | Universiteti “Aleksandër Mojsiu” në Durrës Universiteti i Tetovës |
| 2 | Prof. Dr. Arben Oda | Rebound, rebuild and reinvent for a sustainable and equitable development | Universiteti i Tiranës Universiteti i Tetovës Rrjet i partnerëve të tjerë |
| 3 | Prof. Dr. Brikend Aziri | SMEPP 2022: E-business and the competitive advantage of SMEs | Universiteti i Novi Pazarit Universiteti i Ekonomiksit dhe Shkencave Humane në Varshavë |

Projekti CEEPUS ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim akademik me Fakultetin Ekonomik të Suboticës, konkretisht bashkëpunimi përfshin realizimin e përbashkët të programeve studimore të tre cikleve të studimit; angazhimin e mësimeve dhe bashkëpunëtorëve me qëllim të realizimit të programeve studimore; si dhe shkëmbim të materialit studimor dhe të literaturës profesionale, librave dhe publikimeve universitare; bashkëpunim në projekte kërkimore-shkencore, por edhe në fushën e edukimit dhe aftësimit profesional.

Zbrazëtirat e literaturës akademike për nevoja të studentëve dhe për të qenë në paralele me ndryshimet në programet dhe me trendet botërore ngushtohen për shkak të kontributit shkencor të pedagogëve të brendshëm edhe atë në fushën e ekonomiksit, financave dhe marketingut.

Tabela 22. Libra dhe monografi të botuara nga ana e stafit akademik të Fakultetit Ekonomik

| | |
|----------|---|
| 1 | Publikim i librit universitar me titull “Qeverisja e korporatave” të autorit Brikend Aziri |
| 2 | Publikim i librit universitar me titull “Gjeografia ekonomike” të autorit Sali Zhaku |
| 3 | Publikim i librit universitar me titull “Ekonomia dhe organizimi i turizmit” të autorit Arben Oda |
| 4 | Publikim i tekstit universitar me titull “Qeverisje korporative: Qeverisja me shoqëritë aksionare në Republikën e Kosovës” të autorëve Halit Shabani, Brikend Aziri, Raman Ismaili, Ibish Mazreku |
| 5 | Publikim i monografisë “Strategy” të autorëve Brikend Aziri dhe Raman Ismaili |
| 6 | Publikim i monografisë “Si të bëhemi menaxherë të suksesshëm” të autorëve Izet Zeqiri dhe Brikend Aziri |
| 7 | Publikim i monografisë “Mësimi në distancë gjatë pandemisë COVID-19” të autorëve Izet Zeqiri, Brikend Aziri, Jeton Mazllami dhe Lupço Kocarev |
| 8 | Publikim i monografisë “Si të bëhemi menaxherë të suksesshëm” të autorëve Izet Zeqiri dhe Brikend Aziri |


Në kuadër të ECTS përveç shkëmbimeve të pedagogëve dhe studentëve është realizuar edhe mobilitet i suksesshëm edhe atë shtatë studentë dhe një profesor.

7. REALIZIM I ORËS MËSIMORE NË PROGRAMET STUDIMORE TË FAKULTETIT EKONOMIK

Studentët e Fakultetit Ekonomik kanë dhënë vlerësim mbi procesin mësimor të realizuar gjatë periudhës akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022. Ata janë përgjegjgur në pyetësorë online për procesin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor, edhe atë veçmas për ligjërata dhe veçmas për ushtrime. Në çdo pyetje studentët janë përgjegjgur se sa pajtohen nëse një dukuri e caktuar ka qenë prezente gjatë procesit mësimor, në shkallë prej 1, që nënkupton që dukuria e caktuar nuk ka qenë aspak prezente, deri në 5 ku dukuria e caktuar ka qenë plotësisht prezente.


Studentët e Fakultetit Ekonomik në nivel të përgjithshëm të fakultetit gjithsej kanë dhënë 150 vlerësime, duke përfshirë të gjitha vitet studimore. Në kuadër të këtij vlerësimi në të gjithë indikatorët, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar (M = 4.61). Si vijim, studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave (M=4.6) dhe ushtrimeve (M=4.4) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 1). Lidhshmëria e materialit për përdorim praktik, gjatë orëve të ligjëratave është vlerësuar pozitivisht me (M=4.46) kurse gjatë orëve të ushtrimeve është vlerësuar me (M=4.25). Mësimdhënësit gjatë orëve të ligjëratave kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar (M=4.54), gjatë ushtrimeve niveli i qartësisë është shprehur me (M=4.23).

Grafikoni 1. Vlerësimi i procesit mësimor në Fakultetin Ekonomik




Në programin studimor Marketing - Menaxhment, gjithsej janë dhënë 69 vlerësime. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.53$). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, ($M=4.51$), gjatë ushtrimeve niveli i informimit ka qenë pozitiv ($M=4.12$), se ligjëratat dhe ushtrimet janë të qarta ($M=4.48$; $M=4.11$) dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive si në ligjërata edhe në ushtrime, ($M=4.33$), ($M=4.09$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.58$) dhe ushtrimeve ($M = 4.33$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 2).

Grafikoni 2. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Marketing - Menaxhment




Në programin studimor Ekonomi - Biznes, gjithsej janë dhënë 23 vlerësime. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.39$). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, ($M=4.26$), gjatë ushtrimeve niveli i informimit ka qenë pozitiv ($M=4.17$), se ligjëratat dhe ushtrimet janë të qarta ($M=4.26$; $M=4.13$) dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive si në ligjërata edhe në ushtrime, ($M=4.30$), ($M=4.22$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.48$) dhe ushtrimeve ($M = 4.43$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 3).

Grafikoni 3. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Ekonomi - Biznes



Në programin studimor Financa - Kontabilitet, gjithsej janë dhënë 52 vlerësime. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe i ligjëruar ($M=4.79$). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, ($M=4.71$), gjatë ushtrimeve niveli i informimit ka qenë pozitiv ($M=4.48$), vlerësim pozitiv është shprehur edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata, $M=4.69$; gjatë ushtrimeve shprehet një tendencë më e ulët e qartësisë, por sërish vlerësimi mbetet pozitiv ($M=4.35$); lidhshmëria e përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive në ligjërata edhe në ushtrime është pozitive ($M=4.63$), ($M=4.38$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.62$) dhe ushtrimeve ($M = 4.38$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 4).

Grafikoni 4. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Financa - Kontabilitet



8. SWOT ANALIZA DHE KONKLUZIONI

Gjatë përgatitjes së raportit kemi hasur në bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme nga menaxhmenti, pedagogët dhe administrata e Fakulteti Ekonomik që flet për një klimë bashkëpunuese dhe nivel komunikimi akademik të të gjitha hallkave në kuadër të Fakultetit Ekonomik. SWOT analiza e Fakultetit Ekonomik nxjerr në sipërfaqe fuqitë ku përfshihen:

- statistika të besueshme në dispozicion
- procedura të qarta të regjistrimit të semestrave
- zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të fakultetit
- ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore
- infrastrukturë të përshtatshme dhe klimë pozitive dhe bashkëvepruese
- programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative
- sigurin, bindshmëri dhe qartësi të mësimdhënësve gjatë ligjërimit
- avancim i vazhdueshëm i stafit akademik

Mundësitë:

- lidhja e botës akademike me biznesin
- mundësi mobiliteti të stafit dhe studentëve
- mundësi të lidhjes së teorisë me praktikën
- bashkëpunime
- memorandume

Dobësitë:

- financimi
- numri i pamjaftueshëm i stafit akademik dhe administrativ
- teknologjia informative

Kërcënimet:

- oferta e kuotave jo çdo vit përputhet me kërkesën
- ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësim nga faktorë të jashtëm
- konkurrencë jolojale, që funksionon pa implementim të standardeve të bazuara në Ligjin për arsim të lartë

| Strengths: Fuqitë | Opportunities: Mundësitë |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ✓ Statistika të besueshme në dispozicion ✓ Procedura të qarta të regjistrimit të semestrave ✓ Zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të fakultetit ✓ Ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore ✓ Infrastrukturë e përshtatshme dhe klimë pozitive dhe bashkëvepruese ✓ Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative ✓ Siguri, bindshmëri dhe qartësi e | <ul style="list-style-type: none"> ✓ Lidhja e botës akademike me biznesin ✓ Mundësi mobiliteti të stafit dhe studentëve ✓ Mundësi të lidhjes së teorisë me praktikën ✓ Bashkëpunime ✓ Memorandume ✓ Mundësi bashkëpunimi me organizatat joqeveritare në vend dhe rajon ✓ Aplikime në projekte |

| | |
|---|--|
| <p>mësimdhënësve gjatë ligjërimit</p> <p>✓ Avancimi i vazhdueshëm i stafit akademik.</p> | <p>kombëtare dhe zbatim i teorisë me përvoja të subjekteve që janë pjesë e projekteve.</p> |
| Weaknesses: Dobësitë | Threats: Kërcënimet |
| <p>✓ Mungesë financimi</p> <p>✓ Numër i pamjaftueshëm i stafit akademik dhe administrativ</p> <p>✓ Teknologjia informative</p> <p>✓ Mungesë e pajisjeve harduerike dhe softuerike</p> <p>✓ Mungesë e laboratorëve punues.</p> | <p>✓ Oferta e kuotave jo çdo vit përputhet me kërkesën</p> <p>✓ Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësim nga faktorë të jashtëm</p> <p>✓ Konkurrencë jolojale që funksionon pa implementim të standardeve të bazuara në Ligjin për arsim të lartë</p> <p>✓ Moszbatimi i Marrëveshjes Kolektive në arsimin e lartë në kompensimet e stafit nga organet udhëheqëse të Universitetit</p> <p>✓ Konkurrencë jolojale, që funksionon pa implementim të standardeve të bazuara në Ligjin për arsim të lartë</p> <p>✓ Akreditime të programeve në universitete private/ose shtetërore që nuk plotësojnë standardet e fuqisë punëtore në tregun e punës dhe që nuk janë programe komplementare por krijojnë programe të njëjta dhe zhvillojnë konkurrencë jolojale.</p> |

Komisioni për vetevaluim i Fakultetit Ekonomik:

1. Prof. Dr. Besa Xhaferi - kryetare
2. Doc. Dr. Elsana Aqifi - anëtare
3. Doc. Dr. Teuta Qerimi - anëtare
4. Prof. Dr. Shirete Elezi - anëtare
5. Mr. Sc. Edrina Emini - anëtare
6. - anëtare (studente)
7. - anëtar (student)